



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË
FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT
TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR**

VENDIM

Nr. 63 datë 06.09.2018

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT PËR
NDRYSHIMIN E TARIFAVE TË SHOQËRISË UJËSJELLËS KANALIZIME
LUSHNJË SH. A.**

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a dhe nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, VKM nr. 63, datë 27.01.2016, "Për riorganizimin e operatoreve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura", vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 39, datë 09.12.2015 "Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 09.12.2015 "Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimit të ujërave të ndotura", vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 09.12.2015 "Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimit të ujërave të ndotura" dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 09.12.2015 "Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimit të ujërave të ndotura", Komisioni Kombëtar Rregullator, në mbledhjen e tij të datës 06.09.2018, pasi shqyrtoi relacionin mbi aplikimin e shoqërisë Ujësajllës Kanalizime Lushnje sh. a., përgatitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike,

Konstatohet se:

ERRU në përmbushje të përgjegjësiave ligjore, konkretisht neni 14, neni 22 dhe neni 33 i ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar miraton tarifat e shërbimeve ujësajllës kanalizime në mënyrë që të sigurojë konsumatorët që ofruesit e shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të japin cilësinë më të mirë të mundshme, me një çmim të arsyeshëm dhe në një mënyrë të qëndrueshme financiarisht.

Bazuar në piken 3, të kreut II të VKM nr. 63, datë 27.01.2016, "Për riorganizimin e operatoreve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e

ujërave të ndotura" Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Lushnje sh. a. është licencuar me vendimin e KKRR nr. 40, datë 23.09.2016, "Për licencimin e sh. a. Ujësjetllës Kanalizime Lushnje" pas përfundimit të riorganizimit sipas ndarjes së re territoriale.

Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Lushnje sh. a. ka aplikuar pranë ERRU me shkresën nr. 700 prot. datë 26.06.2018, me lëndë "Kërkesë për nivel të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizime" bazuar në vlerësimin e situatës ekonomike-financiare dhe nevojën për përmirësimin e saj pas riorganizimit sipas reformës administrativo-territoriale. Nga kontrolli formal i dokumentacionit, aplikimit i mungonte "Vendimi i Këshillit Bashkiak Lushnje", dokument i cili u plotësua me shkresë nr. 700/2 prot. datë 26.07.2018.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Lushnje sh. a. për nivelin e ri të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizime.
2. Drejtoria Teknike Ekonomike detyrohet të njoftojë shoqërinë Ujësjetllës Kanalizime Lushnje sh. a. për vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Ndriçim Shani